




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 09.09.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të dt. **08.09.2024 ora 22:09** të parashtruar nga: **OE "WIN 007 SH.P.K."**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " **Digjitalizim i Bibliotekes se Qytetit Fan S. Noli ne Gjilan, permes pasurimit me tablete te mencur me abonim per lexim per te gjithë anetaret e Bibliotekes se qytetit Fan S. Noli ne Gjilan** ", me nr. identifikues 651-24-7334-1-2-1 nxjerr:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar Kërkesa për Rishqyrtim e OE "WIN 007 SH.P.K." kundër vendimit të lartcekur të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull " **Digjitalizim i Bibliotekes se Qytetit Fan S. Noli ne Gjilan, permes pasurimit me tablete te mencur me abonim per lexim per te gjithë anetaret e Bibliotekes se qytetit Fan S. Noli ne Gjilan**" me numër të prokurimit 651-24-7334-1-2-1, inicuar nga AK — Komuna e Gjilanit
- II. VËRTETOHET Vendimi i Autoriteti Kontraktues - Komuna e Gjilanit i datës 02.09.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit " **Digjitalizim i Bibliotekes se Qytetit Fan S. Noli ne Gjilan, permes pasurimit me tablete te mencur me abonim per lexim per te gjithë anetaret e Bibliotekes se qytetit Fan S. Noli ne Gjilan** " me numër prokurimi 651-24-7334-1-2-1.
- III. NJOFTOHET OE ankues si dhe të gjitha palet tjera te interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

IV. Ky vendim hyn ne fuqi ne ditën e nënshkrimit dhe publikimit ne platformën e-prokurimi.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomikë “ WIN 007 SH.P.K “, me datë 08.09.2024 ora 22:09, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Digjitalizim i Bibliotekës së Qytetit Fan S. Noli në Gjilan, përmes pasurimit me tablete të mençur me abonim për lexim për të gjithë anëtarët e Bibliotekës së qytetit Fan S. Noli në Gjilan “ me nr.identifikues 651-24-7334-1-2-1. Autoriteti Kontraktues me datë 18.07.2024 ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga “ Digjitalizim i Bibliotekës së Qytetit Fan S. Noli në Gjilan, përmes pasurimit me tablete të mençur me abonim për lexim për të gjithë anëtarët e Bibliotekës së qytetit Fan S. Noli në Gjilan “, Autoriteti Kontraktues - Kuvendi Komunal Gjilan ka konstatuar se pretendimet e juaja janë të pa bazuara:

Pretendimi nr. 1 :

1. është shkelur dispozita perkatesisht neni 77 pika 2 ku operatori Loni SHPK është pjesëmarrës në dy grupe të operatoreve. gjithashtu kërkojmë të demonstronem saktë ku kërkojmë deklaratën në betim për të gjithë operatorët dhe jo vetëm për operatorin kryesor.

Përgjigjia e AK lidhur me këto pretendime është se :

Bazuar në RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, më saktësisht :

Neni 25

Më saktësisht :

25.6 Autoriteti kontraktues do t'i pranojë si dëshmi të mjaftueshme që asnjëri prej rasteve të specifikuara në nenin 65 të LPP-së nuk aplikohet për Operatorët ekonomik që marrin pjesë në aktivitetin e prokurimit ose në ekzekutimin e cilësdo kontratë publike, si më poshtë:

a. Në lidhje me Nenin 65, paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të LPP-së, deklaratë nën betim e nënshkruar nga Operatori ekonomik në fjalë;

b. Në lidhje me Nenin 65, paragrafët 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 4.1, 4.2 dhe 4.4 të LPP-së, një ekstrakt nga "regjistri gjyqësor" apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ të vendit e themelimit të Operatorit ekonomik;

c. Në lidhje me Nenin 65, paragrafi 4.8, për sigurimet sociale, dhe 4.9 të LPP-së, një certifikatë e lëshuar nga autoriteti kompetent ose Operatori publik që dëshmon se një situatë e tillë nuk ekziston.

d. Në lidhje me Nenin 65, paragrafi 4.8 të LPP-së, për kontributin e taksave një dëshmi e lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit ekonomik.

Gjithashtu,

Neni 26

Grup i Operatorëve Ekonomik 26.1

Një tender mund të dorëzohet nga një grup i Operatorëve ekonomik. Në këtë rast grupi, me tenderin e tyre, duhet të:

a. Dorëzon një deklaratë të qartë që të gjithë anëtarët e grupit janë së bashku dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit, dhe në rast se grupit i jepet kontrata, për performancën e kontratës;

b. Dorëzon një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët, që konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm);

c. Një deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës të veprave në emër të grupit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm; dhe

d. Secili anëtar i grupit duhet të jetë i regjistruar në platformën elektronike, kërkesë e cila duhet të përcaktohet në dosje të tenderit. (Nënshkrimi digjital i avancuar nuk është i obligueshëm deri në njoftim zyrtar nga KRPP); 26.2 Deklaratat e kërkuara në (a), (b) dhe (c) të paragrafit 26.1, mund të përfshihen në një dokument.

26.3 Një grup i OE nuk do të kërkohet të ketë formë të caktuar ligjore në mënyrë që të dorëzoj tenderin por AK rezervon të drejtën, nëse një kërkesë e tillë është e nevojshme për performancën e mirë të kontratës, të kërkoj nga grupi i përzgjedhur të ketë formë të tillë ligjore nëse kontrata i jepet një grupi të tillë si para-kusht të nënshkrimit të kontratës.

26.4 Secili anëtarë i grupit duhet të përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, neni 65 i LPP-se. Në përputhje me këtë nen, secili anëtarë i grupit duhet të dorëzojë së bashku me tenderin e tyre Deklaratën nën Betim dhe në rast se autoriteti kontraktues ka për qëllim dhënien e kontratës grupit në fjalë, secili anëtar i grupit duhet t'i sjellë vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë në përputhje me nenin 65 të LPP-së të specifikuar në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

26.5 Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzoj Çertifikatën e Regjistrimit të Biznesit. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.

Ndërsa, sa i përket asaj se OE Loni SH.P.K. është pjesë marrës në këtë aktivitet të Prokurimit në kuadër të konzurciumit në 2 (dy) OE.

Ne si AK – Autoritet Kontaktues kemi konstatuar se ky pretendim bie poshtë për arsye që kemi të bëjmë me OE e njëjtë që pretendoni ju. Pasi që, bëhet fjalë për LONI SH.P.K. si dhe G.I.Grafo - Loni SH.P.K. dhe jo ashtu siç keni pretenduar ju sepse OE në fjalë nuk korespondojnë të jetë i njëjti OE.

Ku, si rrjedhojë të dëshmuar është edhe nga numëri i Biznesit që e konfirmon këtë.

Autoriteti Kontraktues (AK) - në harmoni me Nenin 1 Qëllimi, Nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti dhe Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi ka hartuar DT duke specifikuar kriteret të cilat nuk e kufizojn konkurrencën nuk diskriminon kundër ose vepron në favor të ndonjë OE.

Rrjedhimisht, AK – Autoriteti Kontraktues qëndron mbrapa Njoftimit të Autoritetit Kontraktues dhe Letrave Standarde - të datës 02.09.2024

Duke parë pretendimet tuaja Ankimore ne si AK kemi shqyrtuar në detaj këto të fundit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës.

Kujtim Bajrami
Menaxher i zyrës së Prokurimit

